

799/4
29.03.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr.444 Akti
Datë 25.01.2015

Nr.412 Vendimi
Datë 29.03.2016

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Gentiana XHELILI

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 29.03.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.444 Akti, që u përket palëve:

PADITËS: "Mangalemi" Sh.P.K me nr.K23206025Q NUIS me seli në lagjen "30 Vjetori" Berat, me Administrator Gjergji Bullari, përfaqësuar në gjykim me autorizimin e datës 22.02.2016 nga Av.Plarent Lapardhaja me nr.4398 license dhe me nr.L03420001A NUIS.

I PADITUR: 1-Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.799/1 prot datë 16.02.2016 nga Silvana Sallo.

2-Drejtoria e Apelitit Tatimor Tiranë, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.509/1 prot datë 16.02.2016 nga Silvana Sallo.

Me pjesëmarrjen në gjykim të Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë (në mungesë).

OBJEKTI: 1-Pavlefshëmrinë absolute të njoftimit të vlerësimit të Detyrimit Tatimor nr.622 prot, datë 14.02.2011 të Rajonale të Tatimeve Berat si dhe të vendimit nr.29448/1 datë 17.11.2015, të Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë "Për lenien në fuqi të gjobes lënten në fuqi të gjobës në shumën 300,000 lekë".

2-Sigurimin e padisë "Pezullimin e ekzekutimit të detyrimit të Njoftimit të Detyrimit Tatimor nr.622 prot datë 14.02.2011, si dhe të Vendimit nr.29448/1 prot datë 17.11.2015, të Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë" deri në përfundim e gjykimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 2,7,10,11,15,17/a,18,21,28/1,29,30/a, 34, 35,40 atë Ligji me nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarveshjeve Administrative". Nenet 45,66,116,117,137 e vijues të Kodit te Procedurave Administrative. Ligji me nr.9920 datë 9.05.2008, nenet, 16, pika 3/c pika 4, neni 18, 80,106,107 (i ndryshuar), Udhezimi nr.24 date 02.09.2008 të Ministrit te Financave;

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat kresore të ndodhura në dosje, dëgjoi palën paditëse shoqëria "Mangalemi" Sh.p.k, përfaqësuesin e saj av. Plarent Lapardhaja i cili kërkoi nga gjykata animin e kërkesë padisë, dëgjoi palën pala e paditur Drejtoria Rajonale timore Berat si dhe Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë, përfaqësuesen e tyre vana Sallo e cila kërkoi nga gjykata rrëzimi e kërkesë padisë, pala sëmarrëse në gjykim Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua këtë gjykim dhe nuk ka paraqitur konkluzione përfundimtare me shkrim në sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykata, pasi ishte në mungesë me gjithë aninë e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në ësi;

V Ë R E N

Se pala paditëse shoqëria "Mangalemi" Sh.p.k i është drejtuar Gjykatës shtet Gjyqësor Vlore me një kërkesë padi me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kesëpadisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit me nr. 194/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe kimitin e mosmarrëveshjeve administrative", çështja objekt gjykimi hyn në idiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të katës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në bazë të nenit 12 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe ksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve ministrative", gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përberë nga një gjyqtar.

Në seancë përgatitore gjykata ka marrë në shqyrtimin e kërkesës se palës itëse për sigurimin e padisë për "Pezullimin e ekzekutimit të detyrimit të ftimit të Detyrimit Tatimor nr.622 prot datë 14.02.2011, si dhe te Vendimit 19448/1 prot datë 17.11.2015, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë deri përfundim e gjykimit", ku gjykata me vendimin me nr.444 akti 10.03.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë të aqitur nga pala paditëse shoqëria "Mangalemi" Sh.P.K.

Rrethanat e faktit:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse shoqëria "Mangalemi" Sh.P.K ushtron aktivitetin e saj si person juridik me objekt të veprimtarisë për sport te udhëtareve urban, interurban e nderkombetar"; agjensi par sport udhetaresh par nevojat e shoqerise", vertetuar nga ekstrakti i listrit tregtar per te dhenat e subjektit shoqëri me pergjegjesi te kufizuar'.

Më datë 28.01.2011 gjate kontrollit te ushtruar nga inspektorët e torisë Rajonale e Tatimore Tiranë eshte konstatuar se në momentin e rollit në automjetet e subjektit "Mangalemi" Sh.P.K me targa Br;5076A, 060A, Br;0672B si dhe automjeti me targë Br;9387A janë gjetur pasagjere apajisur me bileta udhëtimi të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e neve.

Nga inspektorët tatimor janë mbajtur 4 procesverbale gjobe me 002875 ku është dënuar subjekti "Mangalemi" Sh.p.k me gjobe në shumën 80.000 leke, procesverbali me nr.0002865 ku është dënuar subjekti "Mangalemi" Sh.P.K me gjobë në shumën prej 120.000, lekë, procesverbali me 002864 ku është dënuar subjekti "Mangalemi" Sh.P.K me gjobë në

mën prej 60.000 lekë si dhe procesverbali me nr.0002863 ku është dënuar jekti "Mangalemi" Sh.P.K me gjobe në shumën prej 40.000.

Pas kontrollit meqenese pala paditese shoqëria "Mangalemi" Sh.P.K tronte aktivitetin e saj nga Berati në Tiranë, Drejtoria e Tatimeve Berat ka rrë njoftim vlerësimi per detyrimet tatimore me nr.622 prot, datë 02.2011, ku pala paditëse subjekti "Mangalemi" Sh.P.K është nxjerrë itore në shumën prej 300.000(treqind mijë) lekë gjobë.

Pas marrjes së njoftim-vlerësimit tatimor nga Drejtoria Rajonale e meve e Berat, paditësi "Mangalemi" Sh.P.K i është drejtuar Drejtorisë së limit Tatimor me ankimin me nr.29448 prot, datë 01.10.2015 dhe Drejtoria pelimit Tatimor me vendimin me nr.29448/1 prot, datë 17.11.2015 ka dosur refuzimin e ankimit, pasi nuk janë përmbushur kërkesat dhe cedurat e përcaktuara në ligjin me nr.9920, datë 19.05.2008 "*Për cedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar) në lidhje me mos ektimin e afatit të paraqitjes së kërkesës për apelim në Drejtorinë e limit Tatimor Tiranë.

Rezulton se paditësi ka dërguar kërkesën për apelim jashtë afateve ore, pasi akti administrativ njoftim vlerësimi për gjobën në shumën 300.000 objekt apelimi ka dalë në datë 01.04.2011, ndërsa kërkesa për apelim në jtorinë e Apelimit Tatimor është dërguar me datë 01.10.2015.

Nga Drejtori e Apelimit Tatimor me shkresen me nr.29448/1 prot, datë 04.2015 ka vendosur refuzimin e ankimit pasi është paraqitur tej afateve të ashikuara në nenin 106 pika 3.1 të udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008.

Pala paditëse shoqëria "Mangalemi" Sh.P.K pas mos-shqyrtimit të imit nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, i është drejtuar gjykatës me kërkesë li për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim esimi tatimor nr.622, datë 14.02.2011 të Drejtorise Tatimore Berat duke ashtruar se ;

Së pari; paditësi shoqëria "Mangalemi" Sh.P.K, është subjekt i regjistruar në Q.K.R Berat në datë 01.04.2003, me numrin unik te identifikimit te jektit NIPT K23206025Q, i cili ushrtion veprimtarin në "*transportin e iletarëve urban, interurban e nderkombetar; agjenci për transport udhëtarësh nevoja e shoqërisë*".

Kryerja në përgjithësi e çdo operacioni financiar, tregëtar e industrial me uri te paluajtshme e te luajtshme qe mund te lidhen drejteperdrejt ose horazi me nje nga objektet e shoqerise.

Ne mbeshtetje te nenit 83 të ligjit me nr. 9920 date 19.05.2008 "*Per cedural Tatimore në Repitbliken e Shqiperisë*" dhe njohjes me Projekt ortin e Kontrollit, dërguar me shkresen e Drejtorise Rajonale te Tatimeve at nr.622 data 14.02.2011, ne lidhje me gjoben ne shumen 300,000 leke qe hte vendosur paditesit.

Paditësi në bazë të ligjit me nr.9920 datë 19.05.2008, "*Për Proceduralimore ne Republiken e Shqipeisë*" ka paraqitur ankimin prane Drejtorise se limit Tatimor, në Drejtorine © Pergjithshme te Tatimeve, Tirane e cila me dimin e saj nr 29448/1 date 17.11.2015, ka vendosur "*Refuzimin e ankimit, ur me gjobën në shumën 300,000 lekë, në Aktin Administrativ " Njoftim resimi per Detyrimet Tatimore", nr 622 date 14.02.2011, vendosur nga T,Berat, per mosrespektim te afatit të paraqitjes, së kërkesës për apelim në jtorine e Apelimit Tatimore, Tirane*".

Duke parë se ndaj vendimit nr.29448/1 datq 17.11.2015, nxjerrë nga rra e Apelimit Tatimore, Tiranë, mund të bëhet ankimi, pranë Gjykatës Administrative, paditesi është brenda afatit të ankimit dhe për këtë fakt po i het gjykatës Administrative për të shfuqizuar aktin administrative të vlerësimit me nr.622 date 14.02.2011, te Drejtorisë Rajonale Tatimore si dhe te vendimit nr 29448/1 date 17.11.2015, te Drejtorisë së Apelimit r, Tiranë.

Së dyti; paditesit është njoftuar nga DRT, Berat se ndaj Shoqërisë "Mangalemi" Sh.P.K gjatë një kontrolli të ushtruar prane autobuzave të linjes Tirane, nga inspektorët në sektorin zbatim prane Drejtorisë Rajonale re Tirane të katër proces-verbalet të date 28.01.2011, për kate za.

ë kate autobuzat nuk kanë qene në punë në ditën e mbajtjes së verbalit dhe po të shikohen proces-verbalet janë pa vendin e ndalimit, n e ndalimit, dhe pa personal; (shofer), që punojnë në autobuzat s por vetëm me emrin e administratorit.

roçes-verbali është firmosur nga vet inspektorët tatimor dhe jo nga t e autobuzave, ku paditesi shoqëria "Mangalemi" Sh.P.K, nuk disponon nstatimi se nuk janë ndaluar nga ky grup kontrolli.

Për këtë fakt paditesi në datë 25.02.2011 ka bërë kerkese me nr.1057

DRT Berat, në lidhje me gjobën në shumën 300,000 leke pasi nuk ene në dijeni dhe ku nga DRT Berat, paditesi nuk ka marrë asnjë e.

ojarisht nga ish drejtori i DRT.Berat, shoqërisë i është thënë se ishte m vendosja e gjobës ndaj kësaj shoqërie .

ë treti; Në bazë të ligjit me nr.49/2012 " Per Orgaanizimin dhe minin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimeve të Mosmarveshjeve strative", të nenit 106 të Ligjit me nr.9920 "Per Procedurat Tatimore ne ken e Shqiperise", të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008, i ndryshuar të t të Financave, kjo padi bën pjesë në juridiksionin, kompetencën nale dhe kompetencën funksionale tokësore të Gjykatës Administrative llës së Parë Vlorë.

r sa më sipër, paditësi shoqëria "Mangalemi" Sh.p.k kërkoi nga pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

llet e paditura, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat si dhe Drejtoria it Tatimor Tiranë nëpërmjet përfaqësueses së saj Silvana Sallo ka rrezimin e kerkese-padise duke prapësuar në këtë gjykim se;

pari; Me ane të Njoftimit Vlersimit nr.622prot. date 04.02.2011 nga DRT Berat, subjektit i është komunikuar penalteti në vlerë 300 (Gjobe) Denim pa tatim, për shkelje të ligjit nr.9920 dt. 19.09.2008, paisje me bileta udhëtimi nga grupi i kontrollit tatimor Tirane.

la paditese e ka ankimuar aktin administrative për detyrimet tatimore Vlersimit nr.622 prot. date 14.02.2011, në Drejtorinë e Apelimit Tirane, e cila me vendimin nr.29448/1 date 17.11.2015 (prot me DRT : nr.6145date 23.11.2015) ka vendosur Refuzimin e ankimit, pasi nuk mbushur kerkesat dhe procedurat në lidhje me mosrespektimin e paraqitjes së kerkeses për apelim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor.

Së dyti; shoqëria "Mangalemi" shpk, me date 1.10.2015 i është drejtuar drejtorisë së Pergjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Apelit të Tatimor Tirane, me objekt: Kërkese për anulimin e aktit administrativ, të Njoftimit Vlersimit nr.622 prot. date 14.02.2011, për gjobën në shumën 300 000 leke të vendosur nga DRT Berat.

Me vendimin nr.29448/1 date 17.11.2015 të Drejtorisë së Apelit të Tatimor është vendosur "Refuzimin e ankimit" pasi nuk janë përmbushur kërkesat dhe procedurat në lidhje me mosrespektimin e afatit të paraqitjes së kërkesës për apelim në Drejtorinë e Apelit të Tatimor Tirane.

Për sa më sipër shoqëria i është drejtuar kështu Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlore, me objekt "Konstatimin e pavlefshëmrisë absolute të akteve administrative..

Bejmë me dije gjykatën se shoqëria për të njëjtin njoftim vlersim i është drejtuar Gjykatës Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me objekt "Shfuqizim të akteve administrative ...", e cila me vendimin nr. Nr.49 vendimi dt.21.01.2016 ka vendosur "Nxjerrjen e cështjes jashtë juridiksionit".

Subjekti, në objektin e kërkesës padisë së vetë kërkon "Pavlefshmerinë absolute të akteve".

Sqarojmë se në kuptimin e nenit 116 të ligjit Nr.8485, date 12.05.1999 të "Kodit të Procedurave Administrative", shprehet se: "Aktet administrative absolutisht të pavlefshme" Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme; 1-kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; 2- kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; 3-kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Së treti; për sa më sipër në interpretim të këtij neni shprehen se Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, ka vepruar konformë procedurave ligjore, në interpretim dhe në zbatim të ligjit dhe nuk ka bërë asnjë shkelje të nenit të sipërpermendur.

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat është organ i identifikuar, dhe bazuar në nenin 13 të ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe Udhezimit nr.24 date 2.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, "Organizinti i administratës tatimore" ku parashikohet se 1. Administrata tatimore përbehet nga: a) administrata tatimore qendrore, ku përfshihen Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njesitë e tjera të saj.

DRT Berat është organi kompetent për nxjerrjen e akteve administrative, bazuar kështu dhe në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 14 dhe Udhezimit nr.24 date 2.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", pika 14.1 Administrimi tatimor shprehet se: "Në zbatim të pikës 1 të nenit 14 të Ligjit, Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, bashkë me drejtoritë rajonale të saj, është autoriteti i vetëm tatimor qendror në Republikën e Shqipërisë. Si e tillë, ajo është i vetmi autoritet që pranon deklaratat tatimore për tatimet dhe taksat kombëtare, përfshirë deklaratat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vlerëson detyrimet tatimore, kontrollon saktësinë e deklaratimit dhe mbi këto baze, përcakton detyrimet tatimore shtesë të një tatimpaguesi dhe rimbursimin apo kthimin e tatimeve të paguara tepër, nëse ka të tilla. Asnjë organ tjetër, përfshirë këtu Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe strukturat e tjera të auditimit të jashtëm, nuk ka të drejtë të kontrollojë, të

aktoje apo ndryshoje shumen e detyrimeve tatimore te tatimpaguesve te gante".

Aktet administrative Njoftim Vlersimin per detyrimet tatimore Nr.622 prot. date 14.02.2011 dhe vendimit nr.29448/1 date 17.11.2015 i Drejtorise se Apelimit Tatimor prane DPT Tirane, jane nxjerre ne formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji, duke sqaruar si me poshte: a) Njoftim Vlersimin per detyrimet tatimore Nr.622 prot. date 14.02.2011, ka dale ne baze kontrollit te ushtruar nga Inspektorët e Hetimit Tatimor, Sektori i Zbatimit ne Drejtorine Rajonale Tatimore Tirane, duke mbajtur Proçes-Verabalet e gjobave me nr. Serial -0002875, me date 28.01.2011; -0002865, me date 28.01.2011; -0002864, me date 28.01.2011; -0002863, me date 28.01.2011; per mospajtsje me bilata te udhetareve, bazuar ne nenin 122, pika 3 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar, me ligjin nr. 10209, date 23.12.2009, "Kundravajtjet administrative ne perdorimin e paisjeve fiskale, per leshimin e kuponave fiskale e te biletave", cili citon se :1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet ne rast se:"Mosleshimi i biletave te sherbimit me vlere te parashtypur, te perdorura ne sektor te ndryshem, si transport, turizem art kulture etj... denohet me gjobe ne masen 10 000 (dhjete mije) leke per cdo bilete".

Detyrimi i subjektit per leshimin e biletave, percaktohet ne ligjin Nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperis", ndryshuar, 122, pika 3, i i ndryshuar, me ligjin nr.10209, date 23.12.2009.

Ne baze te shkreses se derguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane, nr.7043 prot.date 03.02.2011, protokolluar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Berat me nr.625 date 07.02.2011, me lende: "Dergim proçesverbale gjobe te mbajtura nga Sektori i Zbatimit", per ndjekjen e procedurave te metejshme. Nga ana e inspektorit te vleresimit jane ndjekur procedurat e metejshme, duke plotesuar keshtu formularin "Denimet", Rubriken 3, Denimet per paisjet fiskale, pika e pare, Kundravajtje administrative ne perdorimin e paisjeve fiskale, leshimin e kuponave fiskal e biletave.

Me pas eshte nxjerre Njoftim Vlersimi per detyrimet tatimore me Nr.622 prot. date 14.02.2011, duke ja komunikuar brenda afateve kohore.

Së katërti; Me vendimin nr.29448/1 date 17.11.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor eshte vendosur: "Refuzimin e ankimit".

Pasi nuk jane permbushur kerkesat dhe procedurat ne lidhje me mosrespektimin e afatit te paraqitjes se kerkeses per apelim ne Drejtorine e Apelimit Tatimor Tirane, bazuar ne piken 106.3 .4 te Udhhezimit ku shprehet se: 106.3.4 Ne qofte se ankimi prane Drejtorise se Apelimit Tatimor nuk behet brenda afatit te caktuar, ai konsiderohet i papranueshem dhe refuzohe.

Aktet administrative të nxjerra per shoqerine "Mangalemi" shpk jane kryer në përputhje me ligjin Nr.8485, date 12.05.1999 te "Kodit te Procedurave Administrative" dhe ligjit në fuqi " Për Procedurat Tatimore".

Per sa me siper, Njoftim Vleresimit Nr.622 prot. date 14.02.2011 nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat si dhe Vendimit nr.29448/1 date 17.11.2015, te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, eshte i mbeshtetur ne ligj, si dhe mbeshtetur ne Legjislacionet e siperpermendura, ne nenin 331/1 te Kodit te Procedures Civile dhe nenin 40 pika 3 te Ligjit me nr.49 date 03.05.2012, "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe

gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", palët e paditura kanë kërkuar nga gjykata rrëzimin e kërkesë padisë të ngritur nga shoqëria "Mangalem Sh.K.P dhe lenien ne fuqi te akteve tona administrative si te drejta dhe te bazuara ne ligj.

Për sa më sipër palët e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat si dhe Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë me anë të përfaqësueses së tyre kanë kërkuar nga gjykata rrëzimin e kërkesëpadisë si e pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Pala e pjesëmarrëse ne gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua në këtë gjykim pasi është vijuar gjykimi në mungesë me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe nuk ka depozituar rapësim apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate.

Gjykata pasi kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, administroi provat e paraqitura në gjykim çmon se kërkesë padia e paraqitur nga paditësi shoqëria "Mangalemi" Sh.P.K është e pabazuar në ligj e në prova dhe si e tillë do të rrëzohet.

Arsyetimi ligjor:

Në nenin 7, pika a të ligjit me nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "Gjykata administrative janë kompetente për; mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontrata administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të detyrës nga organi publik.

Në nenin 15 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ; Të drejtën e padisë e ka: çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i tijshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Ne nenin 17 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ;Padia ngrihet;

për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;

Në nenin 18 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se afati për ngritjen e padisë dhe konkretisht afati për ngritjen e padisë:

Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Afati fillon nga:

data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të parit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;

Afati i mësipërm është 1 vit, në rastet kur akti administrativ nuk tregon qartë të drejtën dhe afatin e padisë.

rastin e mosparaqitjes së padisë brenda 1 viti, për arsye se udhëzimet në aktin administrativ nuk japin informacion të saktë për të drejtën e padisë, padia paraqitet edhe pas 1 viti, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data kur

aktësi ka marrë dëjën për ekzistencën e së drejtës së padisë dhe vetëm kur aktësi jep shpjegime të besueshme për këto rrethana në padinë e tij.

Afatet e mësipërme janë të prera dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë. Këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht.

8. Padia për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ mund të ngrihet në çdo kohë.

Rezulton se pala paditëse shoqëria "Mangalemi" Sh.P.K në objektin e kërkesë-padisë kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.622 prot datë 14.02.2011 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat.

Rezulton se ky njoftim është ankimuar në Drejtorinë e Apelit Tatimor dhe nga Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin nr.29448/1 prot datë 17.11.2015 ka vendosur "refuzimin e ankimit" si të papranueshem pasi nuk është respektuar afati ligjor.

Gjykata çmon se njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.622 prot date 14.02.2011 perben një akt administrativ individual në kuptim të nenit 105 të K.Pr.Administrative sipas të cilit **"Per qëllimet e këtij ligji, do të konsiderohen akte administrative të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike në raste individuale"**.

Si një akt administrativ individual, ky akt do të nënshtrohet përcaktimeve ligjore që parashikon Kodi i Procedurave Administrative për aktet administrative në përgjithësi dhe për aktet me karakter individual në veçanti.

Rezulton se pala paditëse kërkon pavlefshmërinë absolute të aktit administrative, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.622 prot datë 14.02.2011 si një akt administrative absolutisht i pavlefshëm si një nga format e pavlefshmërisë së akteve administrative parashikuar në nenin 115 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit **"Pavlefshmëria e akteve administrative, në kuptimin e këtij Kodi, paraqitet në format e mëposhtme:**

- a) akte administrative absolutisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin);
- b) akte administrative relativisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin).

Në nenin 116 të K.Pr.Administrative parashikohet tre rastet se kur një akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm dhe konkretisht **'Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:**

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapercim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Rezulton se akti administrative, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.622 datë 14.02.2011 nuk është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm pasi është nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, i cili

te organi i cakuar me ligj për zbatimin e ligjit "Për procedurat tatimore", nte nxjerre nga nje organ i identifikuar dhe është nxjerre ne zbatim te formes dhe procedures ligjore.

Pra gjykata çmon se nuk jemi para nje akti administrativ absolutisht te pavlefshem qe ne kuptim te 18 pika 8 te tij, kerkimi per konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrative te ngrihet ne çdo kohe.

Në nenin 118 te K.Pr.Administartive parashikohet se 'Aktet administrative do të quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershitim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme.

2. Nje akt administrativ relativisht i pavlefshem eshte i ankueshem ne rruge administrative dhe gjyqesore perkatesisht mbi bazen e dispozitave te ketij Kodi dhe te Kodit te Procedures Civile.

Ne nenin 119 te tij parashikohet se 'Per sa kohe qe akti administrativ relativisht i pavlefshem nuk eshte bere objekt i ankimit administrativ ose gjyqesor brenda afateve te percaktuara nga ky Kod, ose nuk eshte revokuar/shfuqizuar nga organi administrativ kompetent, ai prodhon efektet e nje akti administrativ te vlefshem/ te rregullt ai i neshtrohet rregullave .

Rezulton se njoftim vleresimi per detyrimet tatimore me nr.622 prot datë 14.02.2011 i nxjerrë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat ka dalë në bazë të 4 procesverbaleve të gjobave të mbajtur nga inspektorët tatimor me nr.0002875 ku është dënuar subjekti "Mangalemi" Sh.P.K me gjobe ne shumen prej 80.000 leke, procesverbali me nr.0002865 ku është dënuar subjekti "Mangalemi" Sh.P.K me gjobë në shumën prej 120.000 lekë, procesverbali me nr.0002864 ku është dënuar subjekti "Mangalemi" Sh.P.K me gjobë në shumën prej 60.000 lekë si dhe procesverbali me nr.0002863 ku është dënuar subjekti "Mangalemi" Sh.P.K me gjobe në shumën prej 40.000.

Në nenin 122/3 të ligjit me nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), parashikohet se "3.Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të prodhuara nga institucionet e autorizuar, të përdorura në sektorë të ndryshëm, dënohet me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo biletë".

Sa më sipër, gjykata çmon se kërkesë-padia në themel është e pabazuar në ligj dhe ne prova.

Në rastin objekt gjykimi akti që kundërshtohet(kundërshtohet pjesërisht) ka një vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, shumën 300.000 (treqind mijë) lekë, për rrjedhojë duke patur parasysh se e drejta e ankimit rregullohet me ligj në këtë rast gjen zbatim dhe duhet të mbahet parasysh edhe neni 45 i këtij ligji sipas të cilit përbëjnë vendime të paankimueshme kur shuma e objekti të aktit administrativ që kundërshtohet nuk i kalon njëzet fishin e pagës minimale që është 440.000 (katërqind e dyzet mijë) lekë.

Në zbatim të nenit 106 të K.Pr.civile, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr.444 Akti

Datë 25.01.2015

Nr.412 Vendimi

Datë 29.03.2016

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Gentiana XHELILI

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 29.03.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.444 Akti, që u përket palëve:

PADITËS: "Mangalemi" Sh.P.K me nr.K23206025Q NUIS me seli në lagjen "30 Vjetori" Berat, me Administrator Gjergji Bullari, përfaqësuar në gjykim me autorizimin e datës 22.02.2016 nga Av.Plarent Lapardhaja me nr.4398 license dhe me nr.L03420001A NUIS.

I PADITUR: 1-Drejtorja Rajonale Tatimore Berat, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.799/1 prot datë 16.02.2016 nga Silvana Sallo.

2-Drejtorja e Apelimit Tatimor Tiranë, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.509/1 prot datë 16.02.2016 nga Silvana Sallo.

Me pjesëmarrjen në gjykim të Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë (në mungesë).

OBJEKTI: 1-Pavlefshëmrinë absolute të njoftimit të vlerësimit të Detyrimit Tatimor nr.622 prot, datë 14.02.2011 të Rajonale të Tatimeve Berat si dhe të vendimit nr.29448/1 datë 17.11.2015, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë "Për lenien në fuqi të gjobes lënien në fuqi të gjobës në shumën 300,000 lekë".

2-Sigurimin e padisë "Pezullimin e ekzekutimit të detyrimit të Njoftimit të Detyrimit Tatimor nr.622 prot datë 14.02.2011, si dhe të Vendimit nr.29448/1 prot datë 17.11.2015, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë" deri në përfundim e gjyqimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 2,7,10,11,15,17/a,18,21,28/1,29,30/a, 34, 35,40 atë Ligji me nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarveshjeve Administrative". Nenet 45,66,116,117,137 e vijues të Kodit te Procedurave Administrative. Ligji me nr.9920 datë 9.05.2008, nenet, 16, pika 3/c pika 4, neni 18, 80,106,107 (i ndryshuar), Udhezimi nr.24 date 02.09.2008 të Ministrisë te Financave;